

## **KRITERE TE VECANTA**

### **PER BLERJE ME TENDER ME PROCEDURË:**

## **Blerje Lefterake Elektrike per Terminalin e Autove**

### **1.KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:**

**1.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e fondit limit.

**1.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### **2.KAPACITETIN TEKNIK DHE PROFESIONAL**

**2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, shoqëruar nga faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.  
OSE
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: 2015 ose ekuivalent, ku objekti i saj të përfshijë objektin e prokurimit. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga RSH.

**2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vertetuar nepermjet dokumentave orgjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese për mallin/mallrat e listes:

Ne rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet të paraqesë në leter angazhim ose Akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, mbi të drejtat e furnizimit me llojin e mjetit të ofruar në Republikën e Shqipërisë.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**2.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigorozë. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skeda teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

**2.5** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shenim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

## **KUSHTET PËR TË ZBATUAR NË PRANIM.**

**A. Në fazën e pranimit,** janë të detyruar të paraqesin;

1. **Dokumente origjinale** ose të njëvlefshme, të deklaruara në institucionet tona zyrtare, me anë të të cilave të demonstron, se origjina e prodhimit të materialeve të furnizuara është e njëjtte me ato të paraqitura në dokumentet e ofertimit.
2. Dokumenta që vertetojnë Origjinën e Produkteve.
3. Kataloge ose skeda teknike ,teste që shoqerojnë mallin në fazën e dorzimit.

4. Test raporte
5. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë për mallrat objekt prokurimi Deklaratë/Çertifikatë Konformiteti CE.

**Shenim:**

Në rast të mos paraqitjes dhe mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta në fazën e furnizimit do të konsiderohen si kushte për refuzim të pranimit të mallit.

**VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA**

1. **AUTORITETI KONTRATOR**, rezervon te drejten të kryeje, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, për tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve te kerkuara.

**VI. GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA**

- I. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se merr persiper **monitorimin dhe mirembajtjen e mjetit të ofruar per 2 vite ose 4000 ore pune(ne varesi kush te plotesohet e para)**nga data e marrjes në dorëzim të produkteve.
- II. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se produktet e furnizuara, **janë te reja** si dhe te kenë një garanci përdorimi, **jo me pak 2 vite nga dita e marrjes së tyre në dorëzim**

**VII. AFATI I LEVRIMIT**

1. Afati i lëvrimit kërkohet të jetë për një periudhë 9 mujore nga data e lidhjes së kontrates.

**VIII. OFERTA GJITHASHTU DUHET TË PAJTOHET NË MËNYRË STRIKTE ME TË GJITHA URDHËRAT DHE KËRKESAT E TJERA TE KËTIJ PROKURIMI TE SHENUARA NE DT.**

**KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE KONTRATES**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_